



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

TESTI I MATURËS

GJIMNAZI GJUHËSOR

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

GJUHË SHQIPE

HISTORI

SOCIOLOGJI

GJUHË E DYTË E HUAJ




Prishtinë, qershor 2015

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t' u përgjigjeni 80 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t' i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t' u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t' ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t' u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

GJUHË SHQIPE

Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Vuej bashkë me fëminë të cilit prindi nuk arriti t'ia blejë lojën, vuej bashkë me të riun që digjet n'erotizëm, vuej me pesdhetvjeçarin që mbytet n'apatinë e jetës, vuej me plakun që dridhet nga friga e vdekjes; vuej me bujkun që lufton me tokë, vuej me punëtorin të cilin hekuri e ndrydh. Vuej me njeriun!...

Migjeni (fragment i përpunuar)

1. Fjala “vuej”, që përsëritet njëpasnjëshëm, në fillim të çdo fjalie, ka kuptimin e vuajtjes që vjen nga:
 - A. ndjenja e hidhërimit
 - B. ndjenja e dhembshurisë
 - C. ndjenja e frikës
 - D. ndjenja e përgjegjësisë
2. Duke njohur elementet tematike të veprës së Migjenit, fjalia: “Vuej bashkë me fëminë të cilit prindi nuk arriti t'ia blejë lojën”, ka kuptimin e vuajtjes së poetit për fëmijën, babai i të cili është:
 - A. i paditur
 - B. i pasur
 - C. i varfër
 - D. i pandjeshëm
3. Në këtë fragment jepet ndjeshmëria e poetit ndaj njerëzve:
 - A. të mirë dhe të këqij
 - B. të pasur dhe të bukur
 - C. të dijsëm dhe të padijsëm
 - D. të moshave dhe zejeve të ndryshme
4. Fjalia: “vuej me pesdhetvjeçarin që mbytet n'apatinë e jetës” flet për njeriun që e ka kapluar:
 - A. plogështia e jetës
 - B. kënaqësia e jetës
 - C. ashpërsia e jetës
 - D. beqaria e jetës
5. Fjalët “bujk” dhe “punëtor”, në fjalinë: “vuej me bujkun që lufton me tokë, vuej me punëtorin të cilin hekuri e ndrydh”, janë fjalë që shënjojnë dallimin midis:
 - A. një njeriu që vjen nga fusha e blegtorisë dhe tjetrit që vjen nga fusha e perimtarisë
 - B. një njeriu që vjen nga fusha e agrikulturës dhe tjetrit që vjen nga fusha e industrisë
 - C. një njeriu që vjen nga fusha e bletarisë dhe tjetrit që vjen nga fusha e tekstilit
 - D. një njeriu që vjen nga fusha e pemëtarisë dhe tjetrit që vjen nga fusha e lavëtarisë

6. Në këtë fragment poeti bashkëjeton me vuajtjen e një të riu, siç edhe të një pesëdhjetëvjeçari, porse vuajtjet e tyre, që e veçojnë njërin nga tjetri, janë vuajtje midis:
- të njeriu emocional dhe tjetrit që ka mungesën e emocionit
 - të njeriu të hidhëruar dhe tjetrit që është i revoltuar
 - të një njeriu të dëshpëruar dhe tjetrit që është i shqetësuar
 - një njeriu të arsyeshem dhe tjetrit të paarsyeshem
7. Në rrjedhën e të folurit ndodh që të shqiptohen njëra pas tjetrës dy a më shumë zanore. Çfarë mund të konstatojmë në këto raste, po qe se të dy zanoret që janë bashkë shqiptohen veçmas, duke formuar secila rrokje më vete?
- Rritje të numrit të theksave
 - Zvogëlim të numrit të theksave
 - Kemi rritje të numrit të rrokjeve
 - Zvogëlim të numrit të rrokjeve
8. Çfarë trajtash të bashkuara kemi në këtë lidhje dytrajtësh të shkurtra, përkatësisht shkrirjes së tyre: më + e = ma, si në fjalinë: *Sa herë të shoh ty, ma mbush zemrën me gëzim të madh.?*
- kallëzore të vetës së parë njëjës + dhanore të vetës së parë njëjës
 - dhanore të vetës së parë njëjës + kallëzore të vetës së tretë njëjës
 - dhanore të vetës së parë shumës + kallëzore të vetës së tretë shumës
 - kallëzore të vetës së tretë shumës + dhanore të vetës së parë shumës
9. Ç'është plagjiatura?
- Përdorimi - nga një autor, i fjalëve ose ideve të një autori tjetër, duke i paraqitur si të vetat.
 - Përdorimi - nga një autor, i fjalëve ose ideve të një autori tjetër, prej të cilit nuk keni marrë leje.
 - Përdorimi - nga një autor, i fjalëve ose ideve të një autori tjetër, prej botuesit të të cilit tekst nuk keni marrë leje.
 - Përdorimi - nga një autor, i fjalëve ose ideve të një autori tjetër, duke i paraqitur si jo të vlefshme.
10. Çfarë ndjeshmëri dhe vetëdije mbizotëron në letërsinë e Romanizimit shqiptar?
- universale
 - orientale
 - biblike
 - kombëtare


HISTORI

- 11.** Si zgjedheshin zyrtarët e pushtetit ekzekutiv në Republikën e Romës?
- A. Nga dinastia mbretërore
 - B. Nga Kuvendet popullore
 - C. Me grushtet ushtarak
 - D. Me trashëgimi familjare
- 12.** Njerëzit që lëviznin nga vendi në vend, pa një vendbanim të përhershëm quheshin:
- A. Nomad
 - B. Zejtare
 - C. Tregtarë
 - D. Bujq
- 13.** Cili ishte perandori i parë romak?
- A. Oktaviani
 - B. Pompeu
 - C. Ciceroni
 - D. Cezari
- 14.** “ Në jetën e përditshme ata besonin në shumë Zota dhe adhuronin: Thanën-perëndinë e lindjes (plleshmërisë), Tademi-hyu i dritës dhe Iria-perëndeshë e bujqësisë. Ata po ashtu besonin edhe në jetën pas vdekjes duke u lënë atyre armë, stoli dhe gjëra të tjera.”
- Në tekstin e dhënë bëhet fjalë për besimin e:
- A. Romakëve
 - B. Grekëve
 - C. Thrakasve
 - D. Ilirëve
- 15.** Me kalimin nga rendi feudal në rendin kapitalist fillon:
- A. Koha e Neolitit
 - B. Koha e Re
 - C. Koha e Mesme
 - D. Koha e Vjetër
- 16.** Në fotografinë e dhënë është paraqitur figura e themeluesit të religjionit:
- A. Budist
 - B. Hebraik
 - C. Krishterë
 - D. Hinduist



- 17.** Sundimtari i Perandorisë Osmane, Sulejmani I (1520-1566), në botën perëndimore është i njohur si :
- A. Sulltan Pushtuesi
 - B. Sulltani i Tmerrshëm
 - C. Sulltan Fatihu
 - D. Sulltan Ligdhënësi

- 18.**Në cilën nga betejat e mëposhtme mori pjesë Gjergj Kastrioti Skënderbeu?
- Betejën e Maricës
 - Betejën e Dytë të Kosovës
 - Betejën e Albulenës
 - Betejën e Parë të Kosovës
- 19.**Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës në programin e vetë politik parashihte:
- çlirimin e Kosovës, demokratizimin dhe mbrojtjen e shtetit shqiptarë
 - forcimin e monarkisë së Zogut dhe Çlirimin e Çamërisë nga Serbia
 - bashkëpunimin me Italinë dhe Organizimin e demonstratave protestuese kundër osmanëve
 - organizimin e demonstrative në Gjermani dhe bashkpunimin me SHBA-të
- 20.**Cila ishte gjuha zyrtare e komunikimit në Perandorinë Romake të Perëndimit?
- Gjuha arabe
 - Gjuha latine
 - Gjuha angleze
 - Gjuha frënge
- 21.**Franc Ferdinandi ishte trashëgimtar i fronit perandorak të:
- Rusisë
 - Francës
 - Austro-hungarisë
 - Gjermanisë
- 22.**Marin Barleti është një figurë e njohur e historisë shqiptare që i takon periudhës së:
- Iluminizmit
 - Skolastikës
 - Humanizmit
 - Rilindjes Kombëtare
- 23.**Nga cila fuqi koloniale e deklaroi pavarësinë shtetërore Meksika?
- Franca
 - Britania e Madhe
 - Portugalia
 - Spanja
- 24.**Në gjysmën e parë të shekullit XIX në SHBA u acaruan marrëdhëniet ndërmjet Veriut dhe Jugut. Ky acarim i parapriu luftës civile në vend. Cilat ishin shkaqet shpërthimit të kësaj lufte?
- Vendosja e skllavërisë dhe zhvillimi i hovshëm ekonomik në pjesën jugore të vendit.
 - Tendenca për heqjen e skllavërisë dhe zhvillimi i pabarabartë ekonomik në mes veriut dhe jugut.
 - Vendosja e skllavërisë dhe zhvillimi i hovshëm politik në pjesën perëndimore të vendit
 - Tendenca për heqjen e së drejtës së votës për skllavërit dhe zhvillimi i hovshëm ekonomik në pjesën perëndimore të vendit

- 25.**Gjatë viteve 1839-42 shpërtheu lufta në mes të Kinës dhe Britanisë së madhe që në histori njihet si:
- Lufta e Opiumit
 - Lufta e Mëndafshit
 - Lufta e të Mëdhenjve
 - Lufta e Orientit
- 26.**Besimi i krishterë sipas doktrinës fetare bënë pjesë në grupin e religjioneve :
- Politeiste
 - Monoteiste
 - Totemiste
 - Animiste
- 27.**Në Kongresin e Berlinit (1878) Serbisë ju njohë pavarësia dhe një zgjerim i madh territorial në dëm të tokave shqiptare. Cilat nga dy vendbanimet me shumicë shqiptare iu dhanë Serbisë?
- Qarku i Novipazarit dhe i Shkupit
 - Qarku i Ohrit dhe i Manastirit
 - Qarku i Mitrovicës dhe i Prishtinës
 - Qarku i Nishit dhe i Vrajës
- 28.**Identifikoni ngjarjen historike që lidhet me personalitetin në fjalë :
- Përhapja e reformacionit – Leonardo Da Vinçi
 - Revolucioni i Tetorit -Vlladimir Iliç Lenin
 - Zbulimi i shtypshkronjës –Gjon Buzuku
 - Beteja e parë e Kosovës-Gjergj Kastrioti Skënderbeu
- 29.**Cili armatim modern u përdor për herë të parë në Luftën e Parë Botërore?
- Aeroplanët e dirigjuar
 - Bomba atomike
 - Tanku
 - Raketa
- 30.**Në fotografinë e dhënë është paraqitur figura e patriotit dhe krijuesit letrar shqiptar:
- Gjergj Fishta
 - Fan S. Noli
 - Faik Konica
 - Luigj Gurakuqi
- 
- 31.**Cila ishte njëra nga masat kryesore që ndërmori Bashkimi Sovjetik si reagim ndaj sulmit gjerman gjatë Luftës së Dytë Botërore?
- Përdorimi në masë i armëve biologjike
 - Përdorimi në masë i armëve bërthamore
 - Zhvendosja e industrisë nga viset lindore në pjesën evropiane
 - Zhvendosja e industrisë nga pjesa evropiane në viset lindore

- 32.**Termi “Luftë e Ftohët” është përdorur si sinonim për të shprehur marrëdhëniet e tensionuara pas Luftës së Dytë Botërore në mes të:
- A. Bllokut komunist dhe shteteve perëndimore
 - B. Bllokut nazist dhe fuqive të Antantës
 - C. Paktit trepalësh dhe fuqive të boshtit
 - D. Paktit të Berlinit dhe shteteve mesdhetare
- 33.**Cila ishte kërkesa kryesore e demonstratave të vitit 1981 në Kosovë?
- A. Kosova e Pavarur
 - B. Kosova Republikë
 - C. Bashkimi me Shqipërinë
 - D. Hyrja në Bashkësinë Evropiane
- 34.**Cilat ishin dy nga shtetet që fituan më së shumti nga vendimet e Kongresit të Vjenës (1814-15) ?
- A. Anglia dhe Rusia
 - B. Franca dhe Italia
 - C. Belgjika dhe Holanda
 - D. Spanja dhe Portugalia
- 35.**Cili nga shtetet aziatike të poshtëshënuara filloi i pari procesin e modernizimit në shekullin XIX ?
- A. Kina
 - B. Korea
 - C. Japonia
 - D. Vietnami

SOCIOLOGJI

36.Mikrosociologjia studion:

- A. grupet më të mëdha, institucionet dhe formacionet shoqërore
- B. interaksionin ndërnjerëzor, marrëdhëniet ndërmjet grupeve të vogla shoqërore
- C. faktorët politikë dhe ekonomikë
- D. sistemet e ndryshme socio-ekonomike dhe politike

37.Nocionin *Zoon Politikon* (kafshë politike) e përdori:

- A. Aristoteli
- B. Platoni
- C. Sokrati
- D. Aristofani

38.Sociologjia si shkencë ka lindur gjatë:

- A. kohës së mirëqenies shoqërore
- B. luftërave Ballkanike
- C. luftës së Dytë Botërore
- D. kohës së krizave shoqërore

39.Termin *Sociologji* për herë të parë e përdori:

- A. Sen Simoni
- B. Ogyst Konti
- C. Emile Durkeimi
- D. Maks Veberi

40.Sipas Kontit, struktura shoqërore studiohet nga :

- A. Statika sociale
- B. Dinamika sociale
- C. Mobiliteti social
- D. Ndryshimi social

41.*Solidariteti organik* sipas Durkeimit, është karakteristikë e:

- A. shoqërive antike
- B. shoqërive neolitike
- C. shoqërive të avancuara dhe të zhvilluara
- D. shoqërive të hershme të pazhvilluara

42.Sistemet klasore dallohen prej formave tjera të stratifikimit, për shkak se janë:

- A. më të mbyllura pa mundësi mobiliteti
- B. më hermetike por me mundësi të mëdha mobiliteti
- C. më hermetike por me mundësi të vogla mobiliteti
- D. më të hapura me mobilitet më të theksuar

43.Marksi është angazhuar për:

- A. ndryshime të ngadalshme në shoqëri
- B. ndryshime radikale në shoqëri
- C. ruajtjen e status quo-së në shoqëri
- D. ruajtjen e rendit kapitalist

44.Pushteti karizmatik sipas Veberit karakterizohet:

- A. me qeverisje të qëndrueshme dhe të gjatë kohore
- B. me pushtet të legjitimuar përmes votës së lirë
- C. me veçori hyjnore dhe aftësi magjike të personalitetit udhëheqës
- D. me zgjedhjen e udhëheqësit me procedurë demokratike

45.Monoteizmi është besim:

- A. në një Zot
- B. në shumë zotë
- C. në natyrë
- D. në Totem

46.Në kulturë kiçi është:

- A. imitim dhe vlerë elite
- B. kopjim dhe origjinalitet
- C. kopjim dhe imitim
- D. kreacion dhe origjinalitet

47.Shteti i përcakton normat:

- A. Morale
- B. Ligjore
- C. Populliste
- D. Tradicionale

48.Kastat janë:

- A. pabarazi shoqërore e parregulluar me ligj dhe fe
- B. barazi shoqërore e parregulluar me ligj dhe fe
- C. barazi shoqërore e rregulluar me ligj dhe fe
- D. pabarazi shoqërore e rregulluar me ligj dhe fe

49.Pjesët përbërëse të moralit janë:

- A. normat morale, gjykimet morale dhe sanksionet morale
- B. iluzionet morale, pasionet morale dhe vizionet morale
- C. emocionet morale, pasionet morale dhe motivet morale
- D. iluzionet morale, emocionet morale dhe vegimet morale

50.Ideologjia është:

- A. realitet shkencor
- B. sistem i ideve
- C. grumbull i fakteve të sakta
- D. shprehje e vërtetësisë ideore

51.Dallimet kryesore të racave në aspektin biologjik manifestohen në:

- A. ngjyrën e lëkurës, tiparet e fytyrës dhe ideologjinë
- B. ngjyrën e lëkurës, religjionin dhe konstruksionin fizik
- C. ngjyrën e lëkurës, tiparet e fytyrës dhe gjininë
- D. ngjyrën e lëkurës, tiparet e fytyrës dhe konstruksionin fizik

52.Tërësia e normave, vlerave dhe mënyrave të sjelljes që bën të dallojnë një grup njerëzish nga anëtarët tjerë të shoqërisë, quhet:

- A. makrokulturë
- B. subkulturë
- C. kontrakulturë
- D. teknokulturë

53.Racizmi përkufizohet si:

- A. besim se një grup ose kategori raciale është në thelb superior ndaj të tjerëve
- B. sistem i besimit paragjykes për të tjerët
- C. mendim i gabuar për të tjerët
- D. pretendim për t'i anatemuar të tjerët për fajet e tyre

54.Realizimi i drejtpërdrejtë i qëndrimit të popullit përmes votimit të lirë, quhet:

- A. demokraci totalitare
- B. demokraci plebishitare
- C. demokraci autoritare
- D. demokraci parlamentare

55.Pjesë e rëndësishme e demokracisë liberale janë:

- A. institucionet të centralizuara
- B. institucionet autokratike
- C. institucionet parlamentare
- D. institucionet autoritare

GJUHË E DYTË E HUAJ

(Zgjedhni vetëm njëren nga gjuhët:

Gjuha Gjermane apo Gjuha Frenge)

GJUHA GJERMANE

56. Guten Abend, ich _____ Ariane Müller. Und wie _____ Sie?
A. heißen ... heisst
B. heiße ... heißen
C. Ihrenist
D. Mein ... heist
57. Waren Sie letztes Jahr auch _____ Australien?
A. aus
B. an
C. in
D. nach
58. Martina, woher _____ Lisa? – Sie _____ aus Irland.
A. kommst ... komme
B. kommen ... komme
C. kommst ... kommen
D. kommt ... kommt
59. Welches Wort passt nicht in der Reihe?
A. kalt
B. blau
C. grau
D. gelb
60. Sagen Sie es anders:
Das ist dein Haus.
A. Das Haus gefällt mir
B. Dein Haus fehlt dir
C. Das ist meine Stadt
D. Das Haus gehört dir
61. Welches Verb passt?
Das Essen:
A. vorbereiten
B. ausgeben
C. wechseln
D. decken
62. Warum _____ man eigentlich beim Arzt immer warten?
A. will
B. muss
C. darf
D. kann

63. Anna kauft jedes Wochenende im Supermarkt _____.

- A. auf
- B. be
- C. ein
- D. ver

64. Angelika hat zwei Hobbys.

- Ihre Hobbys sind Tennis _____ und Musik _____ .

- A. spielen ... machen
- B. spiel ... singt
- C. sehen ... hört
- D. spielt ... macht

65. Wir haben nicht viel Zeit. _____ Sie bitte schneller!

- A. Fahret
- B. Fahr
- C. Fahre
- D. Fahren

66. Wie geht der Satz weiter:

Helene war sehr froh, _____ .

- A. ihre Freunde endlich zu sehen.
- B. endlich zu sehen ihre Freunde.
- C. zu sehen ihre Freunde endlich.
- D. Freunde ihre endlich zu sehen.

67. Die korrekte Form des Satzes im *Perfekt* ist:

- A. Er habe letzte Woche ein sehr schönes Buch gelesen.
- B. Er hat letzte Woche ein sehr schönes Buch gelesen.
- C. Er hatte letzte Woche ein sehr schönes Buch gelesen.
- D. Er lesen letzte Woche ein sehr schönes Buch.

68. Ein Satzteil ist falsch. Welcher?

Unser Opa hat immer Witze geerzählt.

- A. Unser Opa
- B. hat immer
- C. geerzählt.
- D. Witze

69. Was passt?

Mama, ich moechte mit Elsa spielen.

- Sie kommt bald aus der Schule. Sag _____ noch einmal!

- A. es ihnen
- B. es ihr
- C. sie ... es
- D. sie ... ihr

70. Welche Stadt ist Deutschlands Hauptstadt?

- A. Berlin
- B. Stuttgart
- C. Bonn
- D. Köln

71. Johann Wolfgang Goethe hat das Drama _____ geschrieben:

- A. Wilhelm Tell
- B. Faust
- C. Nathan der Weise
- D. Romeo und Julia

72. Ordnen Sie den Satz!

Bekannter- Wissenschaftler - Albert - ist - Einstein - ein- .

- A. Albert Einstein bekannter ist ein Wissenschaftler.
- B. Albert Einstein ist Wissenschaftler ein bekannter.
- C. Albert Einstein ist ein bekannter Wissenschaftler.
- D. Ist ein bekannter Wissenschaftler Albert Einstein.

73. _____ wir hier mit der Aufräumung der Wohnung fertig sind, können wir Caffè trinken gehen. Oder?

- A. Nachdem
- B. Bevor
- C. Wenn
- D. Während

74. Wie geht der Satz weiter?

Mein Grossvater war nur zehn Jahr alt, _____.

- A. er seine Eltern verloren habe.
- B. als er seine Eltern verloren hatte.
- C. als er seine Eltern verloren.
- D. seine Eltern er hat verloren.

75. Was passt?

Ich traume China zu besuchen. Ich _____ einmal im Leben die chinesische Mauer _____.

- A. kann... besucht.
- B. möchte.... gehen.
- C. möchte sehen.
- D. dürfen.... sehen.

76. Wir wollten ein schönes Spiel spielen. Ein Spiel wo, _____ die Eltern _____ die Kinder teilnehmen dürften.

- A. je ... desto
- B. entweder ... oder
- C. weder ... noch
- D. sowohl ... als auch

77. Die Deutschen trinken _____ Wein, aber jeder weiss sie trinken _____ Bier.

- A. am liebsten - lieber
- B. am gernsten – am liebsten
- C. gern – am liebsten
- D. schoener – am liebsten

78. Lisa und Leon _____ nicht _____ und haben keine Kinder. Sie leben nur zusammen.

- A. sind ... verheiratet
- B. sind ... geheiratet
- C. haben ... verheiratet
- D. ist ... geheiratet

Lesen Sie bitte den folgenden Text und wählen Sie die richtigen Antworten aus.
Streit im Haus!

Hallo,

Ich bin Patrick und ich bin 18,

Ich verbringe meine Freizeit meistens zu Hause. Da höre ich Musik oder spiele Computerspiele. Ich habe letztes Jahr in den Sommerferien gejobbt und mir einen neuen Computer gekauft. Nachmittags kommen dann auch meine Freunde. Dann spielen wir zusammen und tauschen unsere Spiele aus. Es ist nämlich nicht so teuer, wenn man sich nicht alle Spiele selbst kaufen muss. Meine Eltern sind nicht gerade begeistert von meinen Freizeitaktivitäten. Sie würden es besser finden, wenn ich mich irgendwie mit Sport beschäftigen würde.

Aber das ist nicht das einzige Thema, bei dem es Streit gibt!

79. Patrick interessiert sich für:

- A. Sport und Musik
- B. Musik und Computerspiele
- C. Computerspiele und Sport
- D. Sport und Freizeitaktivitäten

80. Welche Antwort ist falsch:

- A. Patrick hat gejobbt und sich einen Computer gekauft
- B. Nachmittags kommen auch seine Freunde
- C. Patrick tauscht Spiele mit seinen Freunden aus
- D. Seine Eltern sind begeistert von seinen Freizeitaktivitäten

- 56.** Quand tu rencontres quelqu'un pour la première fois, tu dis :
- A. Excusez-moi, je m'appelle Paul.
 - B. Bonjour, je m'appelle Paul.
 - C. Au revoir, je m'appelle Paul.
 - D. A demain, je m'appelle Paul.
- 57.** Le pluriel de *travail* est:
- A. travailx
 - B. travaux
 - C. travaux
 - D. travailles
- 58.** Mes parents sont originaires _____ Gjakova:
- A. à
 - B. vers
 - C. pour
 - D. de
- 59.** Mon frère est étudiant en économie. _____ voudrait travailler avec _____ père. _____ tiendront ensemble une petite compagnie d'informatique. Quelle est la bonne réponse ?:
- A. Il-notre-ils
 - B. Je-mon-elles
 - C. Lui-son-il
 - D. Il-notre-il
- 60.** Quelle est sa mission?
- A. Je dois réformer la justice
 - B. Nous devons trouver un nouveau vaccin
 - C. Tu dois soigner les réfugiés syriens dans les camps.
 - D. Elle doit diriger l'état dignement
- 61.** En 2012, nous avons fêté les _____ ans de l'indépendance de l'Albanie:
- A. cents
 - B. cent
 - C. sans
 - D. cen
- 62.** « *Voyager, c'est découvrir le monde.* ». *Voyager* et *découvrir* sont :
- A. des participes passés
 - B. verbes à l'infinitif
 - C. auxiliaires
 - D. verbes à l'impératif
- 63.** La forme correcte à *l'imparfait* est:
- A. Je ferai mon travail avec ton aide
 - B. Je fis mon travail avec ton aide
 - C. Je faisais mon travail avec ton aide
 - D. J'avais fait mon travail avec ton aide

64. Le synonyme de *belle*:
- A. jolie
 - B. moche
 - C. laide
 - D. affreuse
65. Notre village est tout en pierre. “*Notre*” est un:.
- A. pronom personnel
 - B. adjectif démonstratif
 - C. pronom possessif
 - D. adjectif possessif
66. Quand il a vu _____ enfant-là jouer au football, il a su qu'un jour il deviendrait un champion.
- A. cet
 - B. ce
 - C. cette
 - D. celui-ci
67. ” *Le professeur a finie sa leçon à trois heures*” Dans cette phrase, où est la faute?
- A. leçon
 - B. finie
 - C. trois
 - D. heures
68. Pour acheter *des médicaments*, il faut aller: _____ .
- A. au marché
 - B. à la cave
 - C. à la pharmacie
 - D. au free-shop
69. L'athlète _____ la médaille d'or aux Jeux Olympiques. Mettez le verbe *au passé composé*.
- A. a obteni
 - B. a obtenu
 - C. obtient
 - D. est obtenu
70. Mes amis sont arrivés pour les vacances d'été. Je _____ fait visiter la région.
- A. leur
 - B. lui
 - C. les
 - D. le
71. Il ne comprend ____ le français, ____ l'anglais.
- A. ni ___ pas
 - B. pas ___ ni
 - C. n' ___ pas
 - D. pas ___ pas

72. « *Pénélope a attendu patiemment le retour d'Ulysse* » “*Patiemment*” est?
- A. un adjectif qualificatif
 - B. un épithète
 - C. un adverbe
 - D. un verbe
73. “*même*” rime avec?
- A. Je t'aime
 - B. mémé
 - C. parfait
 - D. fête
74. “*Le nouveau Iphone 6 est arrivé. Élégant, performant, il est fait pour vous. Qu'attendez-vous ?.* » Cela est:
- A. Une lettre d'amour
 - B. Une publicité
 - C. Un mot d'excuse
 - D. Un article de journal
75. Si tu aimes beaucoup les chansons de Rita Ora, tu dis :
- A. Je préfère Beyoncé
 - B. Je déteste Rita Ora
 - C. J'adore les chansons de Rita Ora
 - D. Je n'écoute pas les chansons de Rita Ora
76. le féminin du *roi* :
- A. la regina
 - B. la royale
 - C. la princesse
 - D. la reine
77. Quel est le mot *étranger* ici?
- A. chanteuse
 - B. musique
 - C. fleur
 - D. concert
78. Je suis, tu es, il est, nous _____” continue:
- A. nous sommes, vous êtes, ils sont
 - B. nous avons, vous avez, ils ont
 - C. nous étions, vous étiez, ils étaient
 - D. nous êmes, vous êtes, Ils êtent

79. Les couleurs du drapeau français sont:

- A. blanc, bleu, rouge
- B. bleu, blanc, rouge
- C. rouge, bleu, blanc
- D. rouge, blanc, bleu

80. Qui a écrit "*Les Misérables*?"

- A. Albet Camus
- B. Gustave Flaubert
- C. Honoré de Balzac
- D. Victor Hugo